



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:271255
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05637026

KPPP.nr.2097/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbare të kreditorit Komuna e Prishtinës, kundër debitorit “Matkos Pharm” Sh.P.K., me adresë në Prishtinë Rr. “Shpëtim Robaj”, me NUI: 811159624, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.431/23 të datës 17.08.2023, të Përmbareusit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Matkos Pharm” Sh.P.K., ANULOHET Urdhri Përmbare P.nr.431/23 i datës 17.08.2023, i nxjerrë nga Përmbareusi Privat Destan Bujupaj.

A r s y e t i m

Përmbareusi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.431/23 të datës 17.08.2023, duke lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr.201912703 të datës 19.12.2022, me të cilin e ka detyruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të propozimit dhe urdhrin, në emër të obligimit t’ia paguaj kreditorit shumë prej 1,500.00 Euro, si dhe shpenzimet tjera të krijuara si dhe shpenzimet e procedurës përmbareimore, nën kërcënim të përmbareimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur, e ka kundërshtuar urdhrin përmbareimor, me arsyetimin se fatura e lëshuar nuk është e përshtatshme për përmbareim, ngase sipas nenit 21 dhe 22 të LPP-së përcaktohet saktë se cilat janë dokumente përmbareuese, andaj është vepruar në kundërshtim me

dispozitat e LPP-së dhe LPK-së. Më tej ka theksuar se urdhri për lejimin e ekzekutimit është i parregullt sepse në të nuk janë ofruar prova bindëse dhe ligjore të cilat do të duhej t'i ishin bashkangjitur urdhrit për lejimin e përmbarimit, dhe si i tillë ky urdhër është në kundërshtim me nenin 27 pika 1.2, pasi që i njejti nuk përmban të dhënat bazë që duhet t'i ketë një urdhër. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri për përmbarim të ndalohet në tërësi dhe të anulohen veprimet e kryera, si dhe të obligohet kreditori që të paguajë shpenzimet e përpilimit të prapësimi.

Kreditori në përgjigjen në prapësim, ka theksuar se në bazë të fakteve të paraqitura në kundërshtimin e debitorit, shihet qartë se asnjëra prej tyre nuk paraqet bazë për kundërshtim konform dispozitave të nenit 71 të LPP-së. Më tej ka theksuar se dokumenti përmbarues i nxjerrë në procedurë administrative/kundërvajtëse, në përputhje me nenin 24.4 të LPP-së, është bërë i përmbarueshëm sipas rregullave me të cilat rregullohet kjo procedurë, konkretisht sipas nenit 30.4 të Ligjit për Kundërvajtje. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pabazuar kundërshtimi i debitorit, ndërsa të vërtetohet urdhri për përmbarim i lëshuar nga Përmbaruesi Privat, si dhe të obligohet debitori për shpenzimet e procedurës përmbarimore deri në përfundim të kësaj çështje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata gjeti se fatura Nr.201912703 e datës 19.12.2022, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e as vulën e pranuesit-debitorit.

Duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar detyrimin që rrjedh nga fatura.

Gjykata vlerëson se meqenëse kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë nga e cila rezulton se pranimi i faturës konkrete është bërë në mënyrë të rregullt nga debitori, atëherë rezulton se fatura e lartcekur nuk mund të paraqes bazë për lejimin e përmbarimit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës edhe pse debitori rezultoi fitues i këtij procesi, megjithatë ai nuk e ka bashkangjitur në shkresat e lëndës autorizimin e përfaqësuesit, prandaj gjykata e pati juridikisht të pamundshme t'ia njoh shpenzimet procedurale.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2097/23, më datë 26.04.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.